



Mbështetja e BE-së për të Drejtën e Pronësisë Intelektuale në Kosovë

EuropeAid /139657/DH/SER/XK

Objektivi i përgjithshëm i projektit, pjesë e të cilit do të jetë kjo kontratë është që të mbështesë më tej rolin e Kosovës në qeverisjen ekonomike përmes funksioneve efektive rregullatore në përputhje me detyrimet e MSA-së. Qëllimi specifik i kësaj kontrate është të forcojë kapacitetet ligjore, administrative dhe strukturore të institucioneve të Kosovës të ngarkuara me zhvillimin dhe zbatimin e të drejtave të pronësisë intelektuale (DPI)

Qëllimi: Për të forcuar kapacitetet ligjore, administrative dhe strukturore të institucioneve të Kosovës të ngarkuara me zhvillimin dhe zbatimin e të drejtës të pronësisë intelektuale (DPI). Ky projekt ka për qëllim të përfundojë procesin e përgatitjes së sistemit të pronësisë intelektuale të Kosovës në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Rezultati i projektit do të jetë një sistem plotësisht funksional PI, i harmonizuar me praktikën e BE, i cili siguron një kornizë solide për rritjen e transaksioneve ekonomike që përfshijnë të drejtat e pronësisë intelektuale. Sistemi do të mbështetet nga profesionistë të trajnuar të cilët janë të aftë të trajtojnë çështjet e PI dhe do të veprojnë në një mjedis ku përfitimet e PI dhe nevoja për ta respektuar atë kuptohen mirë nga përdoruesit profesionistë të sistemit dhe shoqërisë në përgjithësi.

Përfituesit kryesorë të Projektit janë:

- Agjencia për Pronësi Industriale e Kosovës
- Zyra për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Lidhura me to
- Divizioni për Mbrojtjen e Pronësisë Intelektuale të Doganave të Kosovës
- Inspektorati i Tregut
- Policia e Kosovës (njësia për krime ekonomike dhe korrupsion dhe njësia e krimit kibernetik)
- Komisioni i Pavarur për Media
- Gjyqësori dhe Zyra e Prokurorëve

Përfitues të tjerë janë:

- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Drejtësisë
- Zyra e Integritetit Evropian, Zhvillimit dhe Dialogut
- Ministria e Ekonomisë
- Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës
- Agjencia për Menaxhimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara,
- Akademia e Drejtësisë e Kosovës
- Agjencia e Kosovës për produkte dhe pajisje medicinale

Projekti ka 3 komponentë, përkatësisht::

- KOMPONENTI 1: Zhvillimi i legjislacionit dhe politikave
- KOMPONENTI 2: Ndërtimi dhe zbatimi i kapaciteteve
- KOMPONENTI 3: Rritja e ndërgjegjësimit